



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 65 të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.10/ 03 prill 2017, Prishtinë) dhe në bazë të nenit 135, nenit 11, nenit 33, paragrafit 3, nenit 29, paragrafit 3, të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2024, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR KËRKESAT E MBROJTJES SË FONDEVE TË APLIKUESHME PËR INSTITUCIONET E PAGESAVE DHE INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është t'i përcaktojë kërkesat për mbrojtje të fondeve nga institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike në përputhje me nenin 11, nenin 33, paragrafin 3, nenin 29, paragrafin 3, dhe nenin 124, nënparagrafi 8.4 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave ("Ligji për Shërbimet e Pagesave").
2. Kjo rregullore zbatohet për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të autorizuar nga Banka Qendrore e Kosovës sipas Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

Shprehjet dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Shërbimet e Pagesave.

### **Neni 3**

#### **Kërkesat e mbrojtjes së fondeve për institucionin e pagesave**

1. Institucioni i pagesave i cili ofron shërbime pagesash të përcaktuara në 1.2.1 deri në 1.2.6 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave do t'i mbrojë të gjitha fondet që i ka pranuar nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave ose nëpërmjet një ofruesi tjetër të shërbimeve të pagesave për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, në njërin nga mënyrat alternative të mëposhtme:
  - 1.1. fondet nuk do të bashkohen në asnjë rast me fondet e ndonjë personi fizik ose juridik, të ndryshëm nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave në emër të të cilëve mbahen fondet dhe, kur ato mbahen ende nga institucioni i pagesave dhe nuk i janë dorëzuar ende përfituesit të

pagesës ose nuk janë transferuar ende te një ofrues tjetër i shërbimeve të pagesave deri në fund të ditës së punës që pason ditën kur fondet janë pranuar, ato do të depozitohen në një llogari të veçantë të mirëbesimit në një bankë të licencuar në Republikën e Kosovës, në BQK ose do të investohen në asete të sigurta dhe likuide me rrezik të ulët, sipas Tabelës 1 të nenit 83 të Rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, për të cilat ngarkesa e kapitalit për rrezikun specifik nuk është më e lartë se 1,6%, por duke përjashtuar zërat e tjerë të kualifikuar të përcaktuar në nenin 84 të asaj rregulloreje dhe ato do të veçohen në përputhje me Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe çdo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës në interes të përdoruesve të shërbimeve të pagesave ndaj pretendimeve të kreditorëve të tjerë të institucionit të pagesave, veçanërisht në rast të falimentimit;

- 1.2. fondet do të sigurohen nga një polic sigurimi ose ndonjë garanci tjetër të ngjashme nga një sigurues ose një bankë, që nuk i përket të njëjtit grup si vetë institucioni i pagesës, për një shumë të barasvlershme me atë që do të ishin veçuar në mungesë të policës së sigurimit ose të garancisë tjetër të krahasueshme, të pagueshme në rast se institucioni i pagesave nuk është në gjendje t'i përmbushë detyrimet e tij financiare.
2. Në zbatimin e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, institucioni i pagesave do t'i miratojë dokumentet e brendshme që vendosin procesin e mbrojtjes së fondeve, procedurat e kontabilitetit dhe të kontrollit të brendshëm të këtyre fondeve. Këto dokumente të brendshme do të rishikohen periodikisht në shpeshhtësinë e zgjedhur nga institucioni. Nëse institucioni zgjedh t'i aplikojë të dyja metodat e mbrojtjes së fondeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dokumentet e brendshme do të specifikojnë qartë se cilat fonde dhe cila metodë do të aplikohen.
3. Termat dhe kushtet e marrëveshjes për hapjen e një llogarie për mbrojtjen e fondeve ose të marrëveshjes për hapjen e një llogarie për mbrojtjen e letrave me vlerë, duke përfshirë çdo shtojcë të këtyre marrëveshjeve, do të specifikojnë se llogaria përkatëse është menduar ekskluzivisht për ruajtjen dhe trajtimin e fondeve të përdoruesve të shërbimit të pagesës të transferuara te institucioni ose të letrave me vlerë të blera në lidhje me fondet që i pranon institucioni nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave, dhe se këto fonde dhe letra me vlerë do të mbeten pronë e përdoruesve të shërbimeve të pagesave të cilët i kanë transferuar ato dhe rikuperimi sipas borxheve të institucionit nuk mund të vendoset mbi këto fonde dhe letra me vlerë.
4. Nëse termat dhe kushtet e marrëveshjes për hapjen e llogarisë për mbrojtjen e fondeve ose marrëveshjes për hapjen e llogarisë për mbrojtjen e letrave me vlerë, duke përfshirë çdo shtojcë të këtyre marrëveshjeve, nuk përmbajnë dispozitat e duhura për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, institucioni do të marrë një konfirmim nga banka ose depozituesi i letrave me vlerë ose të lidhë një marrëveshje të veçantë që përmban të paktën informacionin e mëposhtëm
  - 4.1. datën e lëshimit të konfirmimit ose të lidhjes së marrëveshjes;
  - 4.2. emrin e institucionit;
  - 4.3. numrin/-at e llogarisë/-ve në të cilin/-at mbahen fondet ose letrat me vlerë të përdoruesve të shërbimeve të pagesës të transferuara në institucion;
  - 4.4. një konfirmim që, nga data e specifikuar në konfirmim, llogaria/të do të përdoret/-n ekskluzivisht për mbrojtjen dhe trajtimin e fondeve ose letrave me vlerë të pranuar nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe që pronësia e këtyre fondeve ose letrave me vlerë

do të mbetet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe nuk mund të rikuperohen sipas detyrimeve të institucionit;

- 4.5. nënshkrimin e punonjësit të autorizuar kur lëshohet konfirmimi ose nënshkrimet e të dyja palëve kur lidhet një marrëveshje e veçantë.
5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni aplikohen *mutatis mutandis* për institucionet të cilat zgjedhin të aplikojnë metodën e përmendur në nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të këtij neni.
6. Procedurat e kontrollit të brendshëm do të përfshijnë të paktën barazimin e fondeve, duke krahasuar gjendjen e llogarisë së mbrojtjes së fondeve në fund të ditës së përzgjedhur me shumën e fondeve të përdoruesve të shërbimit të pagesave që do të mbrohen. Periodiciteti i procesit të barazimit do të specifikohet në dokumentacionin e brendshëm. Sa më i madh të jetë rreziku i mospërputhjes ndërmjet këtyre shumave, aq më shpesh duhet të kryhet procedura e barazimit nga institucioni. Barazimi i shumave do të dokumentohet.
  - 6.1. nëse shumat në llogarinë për mbrojtjen e fondeve rezultojnë e pamjaftueshme në raport me shumën e fondeve të përdoruesve të shërbimit të pagesave të cilat duhet mbrojtur, institucioni do t'i identifikojë arsyet e mungesës dhe do ta transferojë menjëherë shumën që mungon në llogarinë për mbrojtjen e fondeve;
  - 6.2. nëse fondet në llogarinë për mbrojtjen e fondeve konstatohen se janë më tepër se fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave të cilat duhet mbrojtur, institucioni do t'i sqarojë arsyet e tepërcës dhe do t'i reduktojë fondet e tepërta në llogarinë për mbrojtjen e fondeve në përputhje me procedurën e përcaktuara në dokumentet e tij të brendshme.
7. Fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave të mbrojtura në përputhje me këtë nen nuk janë pronë e institucionit të pagesave dhe nuk përfshihen në asetet e tij ose në procedurat e likuidimit ose falimentimit, e as nuk i nënshtrohen ekzekutimit ose mbledhjes së detyruar ndaj institucionit të pagesave, e as nuk përdoren si kolateral apo ndonjë lloj sigurie.
  - 7.1. nëse procedurat e falimentimit janë iniciuar kundër institucionit të pagesave, fondet e mbajtura në llogari të veçanta të mirëbesimit, sipas këtij neni dhe nenit 11 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, mund të përdoren vetëm për t'i përmbushur detyrimet e institucionit të pagesave ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave.
8. Kur një institucioni pagesash i kërkohet të mbrojë fondet sipas paragrafit 1 dhe një pjesë e këtyre fondeve do të përdoret për transaksionet e ardhshme të pagesave dhe pjesa e mbetur do të përdoret për shërbime që nuk kanë të bëjnë me pagesat, ajo pjesë e fondeve do të përdoret për transaksione të ardhshme të pagesave do t'i nënshtrohen gjithashtu kërkesave të paragrafit 1.
  - 8.1. kur ajo pjesë e fondeve është e ndryshueshme ose nuk dihet paraprakisht, institucionet e pagesave mund ta aplikojnë këtë paragraf në bazë të një pjese përfaqësuese që supozohet se do përdoret për shërbimet e pagesave, me kusht që kjo pjesë përfaqësuese të mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme në bazë të të dhënave historike sipas kërkesës së BQK-së.
9. Një institucion pagesash duhet, një muaj përpara, ta njoftojë BQK-në për ndryshime të mëdha në kërkesat e mbrojtjes së fondeve të përcaktuara me këtë nen dhe të aplikueshme për fondet e pranuar nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave.

## **Neni 4**

### **Kërkesat e mbrojtjes së fondeve për institucionet e parasë elektronike**

1. Institucionet e parasë elektronike do t'i mbrojnë fondet që i kanë pranuar në këmbim të parasë elektronike që është emetuar, në përputhje me nenin 11 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe nenin 4 të kësaj rregulloreje:
  - 1.1. fondet e pranuar në formën e instrumentit të pagesës me pagesë nuk ka nevojë të mbrohen derisa ato të kreditohen në llogarinë e pagesave të institucionit të parasë elektronike ose të vihen në ndonjë mënyrë tjetër në dispozicion të institucionit të parasë elektronike në përputhje me kërkesat e kohës së ekzekutimit në seksionin III të Ligji për Shërbimet e Pagesave, aty ku është e zbatueshme;
  - 1.2. në çdo rast, këto fonde do të mbrohen jo më vonë se pesë ditë pune, pas emetimit të parasë elektronike.
2. Neni 11 i Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe neni 3 i kësaj rregulloreje aplikohen për institucionet e parasë elektronike për aktivitetet e përmendura në nënparagrafin 1.1 të nenit 32 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave që nuk janë të lidhura me aktivitetin e emetimit të parasë elektronike.
3. Institucioni i parasë elektronike duhet, një muaj përpara, të njoftojë BQK-në për ndryshime të mëdha në kërkesat e mbrojtjes së fondeve të përcaktuara me këtë nen dhe të aplikueshme për fondet që i pranon nga mbajtësit e parasë elektronike për paranë elektronike të emetuar.

## **Neni 5**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do t'i nënshtrohet masave korrigjuese dhe/apo ndëshkimeve administrative të përcaktuara në nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150, dhe nenin 124, paragrafin 8, nënparagrafin 8.4, të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

## **Neni 6**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen dispozitat për ruajtje të fondeve të përcaktuara me Rregullore për kapital rregullator dhe ruajtje të fondeve të klientëve të institucioneve financiare jobankare, të miratuar nga Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 29 nëntor 2019.

## **Neni 7**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 10-(dhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës